

VENDIM
Nr. 217, datë 13.4.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1039, DATË 16.12.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
PËR EMETIMIN, PRODHIMIN, PËRDORIMIN
DHE TREGTIMIN E PULLËS POSTARE SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 1039, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“24. Pullat postare shqiptare shtypen në ente të specializuara, të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm për shtypjen e letrave me vlerë, certifikatë cilësie dhe sigurie të shtypit.”.

b) Në nenin 25, fjala “... shtypja ...” hiqet.

2. Ngarkohet Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku